



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3535/Prot
2

Vlorë, më 04.03 2026

V E N D I M

Nr. 19, datë 28.02.2026

**“PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË BASHKIAKE “VLORA INVEST” SH.P.K., NË PRONËSI
100% TË BASHKISË VLORË”**

Në mbështetje të neneve 11, 13, 59, 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 69, 70, 71 - 104 të Ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Neneve 8, 9, 23, 54, 64 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”; Ligjit nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”; VKM Nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar;; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; me propozimin e Kryetarit të Bashkisë si dhe me propozimet e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë gjatë shqyrtimit të Projektvendimit, Aktit të Themelimit dhe Statutit, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2026,

V E N D O S I:

1. Të krijohet shoqëria bashkiake me përgjegjësi të kufizuar me emrin “VLORA INVEST” SH.P.K., me pronësi 100% të Bashkisë Vlorë.
2. Shoqëria do të ketë formën juridike “SH.P.K” dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin nr. 9901/2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar.
3. Çdo pasuri e luajtshme dhe/ose e paluajtshme në pronësi apo administrim të Bashkisë Vlorë, që i vihet në dispozicion shoqërisë “VLORA INVEST” SH.P.K për përdorim, administrim dheose zhvillim, në të gjitha rastet miratohet paraprakisht nga Këshilli Bashkiak.
4. Asetet që i jepen për përdorim, administrim dhe/ose zhvillim shoqërisë nuk mund të tjetërsohen, nuk mund të transferohen, nuk mund të përdoren si peng apo garanci dhe mbeten në të gjitha rastet në pronësi të Bashkisë.
5. Miratimin e aktit të themelimit (aneksi 1) dhe statutit (aneksi 2) të shoqërisë “Vlora Invest” sh.p.k.

6. Pronari i vetëm dhe ortakut i vetëm i shoqërisë është Bashkia Vlorë, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Asamblesë së Ortakëve.
7. Shoqëria do të ketë selinë në qytetin e Vlorës, Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë, pranë godinës së Bashkisë Vlorë.
8. Të ngarkojë Kryetarin e Bashkisë apo personin e autorizuar prej tij, që të nënshkruajë aktet e themelimit të kësaj shoqërie tregtare si dhe për ndjekjen e procedurave për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
9. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi/at i/e autorizuar prej tij që të përfaqësojë Bashkinë Vlorë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "VLORA INVEST" SH.P.K, me përjashtim të rasteve kur në statutin e shoqërisë përcaktohet ndryshe.
10. Kapitali fillestar i shoqërisë "VLORA INVEST" SH.P.K. përcaktohet në vlerën 100 (njëqind) lekë dhe sigurohet nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2026. Transferimi i kapitalit fillestar kryhet pas regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me procedurat financiare dhe ligjore në fuqi.
11. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit për ndjekjen e procedurave financiare që lidhen me krijimin dhe funksionimin fillestar të shoqërisë, përfshirë dokumentacionin financiar, mbështetjen buxhetore dhe transferimin e kapitalit fillestar.
12. Bashkia Vlorë vendos në dispozicion të shoqërisë "VLORA INVEST" SH.P.K., me miratimin e Këshillit Bashkiak Vlorë, nga inventari i pasurive në pronësi ose administrim të Bashkisë Vlorë, ambjentet dhe asetet e nevojshme për fillimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërisë, sipas akteve përkatëse administrative. Këto veprimtari ushtrohen vetëm nëpërmjet administrimit, zhvillimit dhe/ose të drejtës së përdorimit të pasurive publike të Bashkisë, pa transferim pronësie dhe pa cenuar tagrat e pronarit publik.
13. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë:
 - Shoqëria ushtron veprimtari tregtare në fushën e turizmit, kulturës, zhvillimit bujqësor dhe blegtoral, projekteve në lidhje me energjinë e rinovueshme dhe në çdo fushë tjetër që çmohet e nevojshme dhe që është në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Aktiviteti tregtar i shoqërisë zhvillohet me qëllim realizimin e fitimit dhe gjithmonë në funksion zhvillimit ekonomik në bashkinë Vlorë.
 - Në funksion të aktivitetit tregtar si më sipër, shoqëria tregtare mund të përfshihet në fushën e menaxhimit të plazheve publike dhe hapësirave bregdetare, hapësirave publike, zhvillimit dhe zbatimit të projekteve turistike dhe promovimit të destinacionit, ndërtimit, rindërtimit, rikonstruksionit të aseteve që i janë dhënë në përdorim apo administrim si dhe menaxhimit të eventeve publike me synim zgjatjen e sezonit turistik dhe rritjen e vlerës ekonomike të territorit.
 - Shoqëria tregtare nxit dhe koordinon projekte zhvillimore në sektorin bujqësor dhe blegtoral, përfshirë bashkëpunimin me fermerët dhe blegtorët e zonës, mbështetjen e prodhimit vendor, rritjen e cilësisë dhe qëndrueshmërisë ekonomike, si dhe integrimin e prodhimeve lokale në zinxhirët e vlerës turistike dhe tregtare të bashkisë, në bashkëpunim me të gjithë aktorët publik dhe privat, kooperativat bujqësore, shoqatat e fermerëve dhe subjektet agro-përpunuese.
 - Shoqëria tregtare identifikon, harton, zbaton dhe menaxhon projekte zhvillimore shumë-sektoriale në fushën e turizmit, bujqësisë, zhvillimit rural, mjedisit dhe kulturës, duke shfrytëzuar fondet bashkiake, fondet kombëtare, fondet e donatorëve, programet e Bashkimit Evropian, si dhe forma të tjera financimi, bashkëfinancimi dhe bashkëpunimi strategjik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesin publik.
 - Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj, Shoqëria, me iniciativë të saj dhe/ose me propozim të institucioneve, enteve publike, personave fizikë apo juridikë privatë, vendas apo të huaj, identifikon zona dhe/ose pasuri të paluajtshme me qëllim zhvillimi gjithmonë duke ju

nënshtruar një procesi konsultimi publik me komunitetin përkatës. Shoqëria mund t'i zhvillojë këto pasuri si investitore dhe/ose zhvilluese, vetë ose në bashkëpunim me sektorin publik dhe/ose privat, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Shoqëria, sipas rastit, vendos të jetë investuese dhe/ose zhvilluese e vetme në projekt investimi ose bashkëzhvilluese dhe/ose bashkëinvestuese, në bashkëpunim me sektorin publik dhe/ose privat, porositëse e investimit apo bashkëpjesëmarrëse në investim, në çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Forma e financimit të investimit të ndërtimit, si dhe forma e bashkëpunimit, përcaktohen me vendim të posaçëm të Këshillit Bashkiak dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Në funksion të aktivitetit të saj tregtar, shoqërisë tregtare mund ti jepen për përdorim, administrim apo zhvillim asete, pasuri të luajtshme apo të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Vlorë dhe ti përdorë, administrojë dhe/ose zhvillojë ato, vetë, në bashkëpunim apo nëpërmjet subjekteve të treta, por gjithmonë në përputhje me miratimin paraprak të dhënë nga Këshilli Bashkiak Vlorë. Për përdorimin, administrimin dhe/ose zhvillimin e aseteve pronë e Bashkisë Vlorë, shoqëria tregtare zbaton në çdo rast kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë si dhe aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Bashkiak Vlorë. Në çdo rast, asetet i jepen për përdorim, administrim dhe/apo zhvillim shoqërisë tregtare vetëm me miratim të Këshillit Bashkiak.
14. Shoqëria "VLORA INVEST" SH.P.K. ka të drejtë të hyjë në marrëdhënie kontraktuale, marrëveshje, akte bashkëpunimi apo forma të tjera juridike të lejuara nga ligji, me palë të treta vendase ose të huaja, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj ekonomike, gjenerimit të të ardhurave dhe nxitjes së zhvillimit të turizmit, bujqësisë dhe ekonomisë lokale
 15. Organet drejtuese të shoqërisë janë:
 - Asambleja e Ortakëve, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Vlorë, ose personi/at i/e autorizuar prej tij;
 - Administratori i shoqërisë, i cili emërohet nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet themeluese të shoqërisë.
 16. Administratori është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e veprimtarisë së shoqërisë, për zbatimin e statutit, aktit të themelimit dhe vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, si dhe për raportimin periodik të gjendjes financiare dhe operacionale të shoqërisë pranë Bashkisë Vlorë.
 17. Shoqëria "VLORA INVEST" SH.P.K. mban regjistrim të plotë kontabël dhe pasqyra financiare, në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit dhe legjislacionin në fuqi.
 18. Fitimi vjetor i shoqërisë, pasi të jenë shlyer në kohë të gjitha detyrimet tatimore, financiare dhe kontraktuale, përfshirë detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve dhe palëve të treta, i transferohet Bashkisë Vlorë, në masën dhe mënyrën që përcaktohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, duke marrë parasysh nevojat për arritjen e objektivave, synimeve, fushës së veprimtarisë, si dhe nevojat për funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë.
 19. Shoqëria harton çdo vit planin vjetor të veprimtarisë dhe pasqyrat financiare, të cilat miratohen nga Asambleja e Ortakëve dhe i paraqiten Këshillit Bashkiak Vlorë për informim dhe transparencë çdo 6 (gjashtë) muaj.
 20. Bashkia Vlorë, nëpërmjet strukturave të saj përkatëse, ndjek dhe monitoron aspektet financiare dhe administrative të veprimtarisë së shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 21. Shoqëria mund të krijojë zyra apo filiale, brenda dhe jashtë territorit të Bashkisë Vlorë, kudo ku kjo vlerësohet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë dhe arritjen e objektivave dhe synimeve të saj, me miratim të Asamblesë së Ortakëve.
 22. Ngarkohet Administratori i shoqërisë, pas emërimit, të ndërmarrë të gjitha procedurat e nevojshme për pajisjen me NIPT, regjistrimet përkatëse fiskale, hapjen e llogarive bankare,

organizimin e strukturës administrative dhe funksionale të shoqërisë, si dhe lidhjen e marrëdhënieve kontraktuale të domosdoshme për fillimin e veprimtarisë.

23. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Vlorë, Drejtoria e Financës dhe Planifikimit të Buxhetit, Drejtoria Publike e Menaxhimit të Aseteve si dhe Administratori i shoqërisë "VLORA INVEST" SH.P.K., pas emërimit.
24. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55/6 të të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR
Elpiniqi Mërkuri

